



DOGANA E KOSOVËS - CARINA KOSOVA - KOSOVA CUSTOMS

10.06.2022 DALJE - IZLAZ - PASSING

No/Br/No. 01/626/2022

Drejtoria e Doganës - Opšta Uprava - Central Administration

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera
- Ministry of Finance, Labour and Transfers



Dogana e Kosovës - Carina Kosova - Kosovo Customs
Zyra e drejtorit të përgjithshëm

LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

REFERENCË:	05/47 Nr. prot.783.1				
PËR/ZA/TO:	Vlora Spanca- Auditor i Përgjithshëm ,Republika e Kosovës.				
CC:	Emine Fazliu – Ndihmës Auditor i Përgjithshëm; Faruk Rrahmani - Drejtor i Departamentit të Auditimit; Arta Kryeziu-Udhëheqëse ekipi				
PËRMES/PREKO/THROUGH:					
NGA/OD/FROM:	Agron Llugaliu –Drejtor I Përgjithshëm i Doganës së Kosovës.				
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Plani I Veprimit-Raporti Final i Doganës së Kosovës për vitin financiar të përfunduar më 31 Dhjetor 2021				
Nr. i zyrës:	Tel & Fax (++)	Lokacioni:	Drejtoria e Doganës, Lagjja	Data:	
Br. kancelarije:	381 38) 540	Kucni:	Kalabri, Rr. Rexhep Krasniqi	Datum:	09/06/2021
Room No.:	350 /540 836	Extension:	Prishtinë	Date:	
PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/for action					
VËMENDJA JUAJ/VASA PAZNJA/YOUR ATTENTION					X
SIÇ ËSHTË KËRKUAR/KAKO JE ZATRAZENO/AS REQUESTED					X
PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION					X
AFATI/KRAJNI ROK/DEADLINE					X

Drejtoria e Doganës, Lagjja Kalabri, Rr. Rexhep Krasniqi 10.000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel & Fax (++) 381 38) 540 350 /540 836
www.dogana-ks.org

E nderuara znj. Spanca,

Shpresoj se jeni mirë me shëndet dhe punët po ju shkojnë mbarë!

Ne kemi shqyrtuar dhe analizuar Raportin Final të prezantuar nga ekipi i auditimit të ZKA dhe kemi vlerësuar gjetjet dhe rekomandimet e dhëna në këtë raport.

Dëshiroj po ashtu të ju falënderojmë për punën profesionale që ekipi juaj ka bërë gjatë auditimit të “Doganës së Kosovës për vitin financiar të përfunduar më 31 Dhjetor 2021“ si dhe për bashkëpunimin e shkëlqyeshëm që kanë pasur me zyrtarët doganor, për gjatë tërë kohës.

Duke e ditur peshën që ka raporti i auditimit për Institucionin e Doganës si dhe peshën që ky Institucion ka në shoqëri dhe për Buxhetin e Kosovës, ne si një Organizatë Buxhetore besojmë që të gjeturat dhe rekomandimet tuaja do të na ndihmojnë në arritjen e objektivave të parapara.

Ne kemi përgatitur Planin e Veprimit lidhu me adresimin e rekomandimeve të dhëna në këtë raport, si dhe masat që ne kemi ndërmarrë në lidhje me të gjeturat në Raportin Final.

Komentet tona dhe përkushtimi për Implementimin e Rekomandimeve (konkretisht përmirësimin eventual) janë domethënës dhe na ndihmojnë për përmirësimin e performancës së institucionit tonë në vazhdimësi.

Jeni të mirëseardhur në auditimet e radhës!

Me respekt,
Agron Llugalij
Drejtor i Përgjithshëm
Dogana e Kosovës



09 Qershor 2022

Prishtinë

Nr	Komponenta e Auditimit (Kapitulli)	Të gjeturat /Çështjet	Rekomandimi	Veprimet e Ndërmarra	Personat Përgjegjës	Afati i përfundimit
1.	Paga dhe mëditje	<p>Sipas planit të shpërndarjes së stafit me nr. Protokollit 01/837 të datës 16.03.2021 i bërë në bazë të UA nr.59/2019 për ndryshim plotësim të UA nr.39/2017 për strukturën organizative, Dogana kishte të aprovuar 581 punonjës, përderisa numri i zyrtarëve në fund të vitit 2021 ishte 559.</p> <p>Për vitin 2021, Dogana edhe pse kishte fonde (sipas Ligjit të buxhetit), nuk kishte përgatitur plan për rekrutim të stafit dhe si rrjedhojë nuk ishte zhvilluar asnjë proces të rekrutimit të jashtëm. Po ashtu, nuk ishin zhvilluar as procese për avancim të brendshëm përkundër faktit se në fund të vitit, 26 pozita menaxheriale ishin të lira (5 pozita ishin të mbuluara me zëvendësues, 8 me emërim të përkohshme ndërsa 13 të paplotësuara fare).</p> <p>Sipas zyrtarëve të DK-së, kjo situatë qëndron për arsye se janë duke u bërë disa korrigjime në udhëzimin përkatës administrativ për rregullimin e marrëdhënies së punës për oficerët doganor, por që kjo gjendje po vazhdon ende.</p>	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprime konkrete për aprovimin e Udhëzimeve përkatëse dhe plotësimin e vendeve të lira të punës sipas Strukturës Organizative, duke i dhënë rëndësi të veçantë pozitave menaxhuese në kuadër të organizatës	<p>Gjatë vitit 2021, nuk janë zhvilluar procedura të avancimit të stafit përmes konkurseve të brendshme për faktin se na është dashur të fillojmë me korrigjimin e U.A. 37-2016 për Rregullimin e Marrëdhënies së Punës së Oficerëve Doganor, sipas së cilit akt rregullohet procedura e rekrutimit dhe avancimit të stafit.</p> <p>Për më tepër ju njoftojmë plotësim ndryshimi i UA ka qenë një proces i një projekti në kuadër të zyrës ligjore të Kryeministrit që ka kërkuar që UA në kuadër të Agjencive Ekzekutive të anulohen dhe UA për agjensionet të nxjerr Ministri përkatës. Fillimisht është pritur për të parë vendimin për këtë çështje, ndërkaq që pas sqarimit që i është bërë Ministrit se jemi duke nxjerr kodin e ri doganor dhe se me nxjerrjen e kodit të ri do të fillojmë që kompetencën e nxjerrjes së UA-ve ta bartim tek Ministri dhe zyra ligjore e</p>	DP DSHP dhe BNJ	Gjatë vitit 2022

				<p>KM, i njëjti është pajtuar ndërkohë me këtë propozim dhe tani ky akt nënligjor është duke u finalizuar me plotësim ndryshimin dhe presim që me finalizimin e tij të fillojmë me përmbushjen e pozitave vakante.</p> <p>Vlen të potencohet fakti se ne kishim propozim planin për vitin 2021 për plotësimin e pozitave të lira përmes konkurseve të brendshme përfshirë edhe ato menaxheriale si dhe rekrutimin e pozitave të lira përmes konkursit të jashtëm, por i cili nuk u zbatua për arsyet e cekura si më lartë.</p>		
2.	Pasuritë kapitale dh jokapitale	Sipas nenit 6, pika 3 e Rregullores MF - Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin "e-pasuria". Po ashtu, neni 2 thekson se të gjitha organizatat buxhetore janë të obliguara që të marrin masat e nevojshme për dokumentimin, ruajtjen, evidentimin, tjetërsimin dhe raportimin e pasurisë jo financiare me qëllim të menaxhimit më efektiv, efikas dhe ekonomik me qëllim të mbrojtjes së	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se të gjitha pasuritë nën 1000€ regjistrohen në sistemin e-Pasuria dhe të ketë një menaxhim efektiv të pasurive të amortizuara - jashtë përdorimit në mënyrë që prezantimi i tyre në PFV të jetë i plotë dhe i saktë.	Janë regjistruar si pajisje shpenzuese në sistemin e-pasuria 16 RAM Memoriet për servera.	Zyrtari për regjistrimin të pasurisë	Gjatë vitit 2022

	<p>pasurisë jo financiare nga dëmtimi dhe keqpërdorimi. Ne identifikuam që:</p> <ul style="list-style-type: none"> <input type="checkbox"/> 16 ram memorie për serverë në vlerë 9,361€ nuk ishin regjistruar në sistemin e-pasuria; <input type="checkbox"/> Dogana ende nuk ka një regjistër të plotë të pasurisë nën 1,000€ në sistemin "e pasuria". Evidencat për pasuritë jo kapitale nën 1,000€ mbahen në dy regjistra të ndara. Pasuritë jo kapitale të blera nga viti 2018 - 2021 janë të regjistruara në sistemin "e-pasuria" (vlera 220,925€), ndërsa pasuritë tjera (vlera 150,173€) që i përkasin viteve të më hershme (para vitit 2018) janë të evidentuara në një sistem të brendshëm "Inventory"; dhe <input type="checkbox"/> Dy pajisje të TI-së nuk kemi arritur t'i identifikojmë gjatë ekzaminimit fizik, pasi që në depon ku ishin vendosur pasuritë e vjetra ato ishin pa barkode. Në raportin e komisionit të Inventarizimit, 1335 pajisje dhe inventar të cilat kryesisht ishin jashtë përdorimit e kishin statusin "të pagjetura" për të cilat ishte rekomanduar të formohet komisioni për vlerësimin dhe tjetërsimin e tyre. Komision kishte klasifikuar pasuritë për asgjësim dhe tjetërsim, kurse pjesën tjetër kishte rekomanduar që atyre tu vendosen barkodet dhe të mbahen në evidencat e pasurive. Problemi i mos regjistrimit të disa pasurive në e-pasuri vjen nga menaxhimi jo efektiv i tyre nga ana e zyrtarëve të pasurisë, kurse arsyeja e regjistrimit jo të plotë të pasurisë nën 1,000€ në sistemin 		<p>Në momentin që MPB krijon kushte për funksionim stabil të sistemit e-pasuria duke angazhuar ndonjë operator ekonomik kompetent dhe të aftë për bartjen e të gjitha të dhënave atëherë Dogana do të ndërmerr veprime për të azhurnuar me rregull regjistrat e plota të pasurisë.</p>	<p>ZKF/ ZKA.</p>	
--	--	--	--	----------------------	--

		<p>"e-pasuria" është për shkak të vonesave në bartjen e të gjitha të dhënave nga ana e programerëve të cilët e menaxhojnë këtë softuer (kontratën për këtë softuer e menaxhon Ministria e Punëve të Brendshme).</p>				
--	--	---	--	--	--	--